



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

Drejtuar: Operatorit ekonomik “Alba Construction” shpk

Adresa: Rruga “Frederik Shiroka”, Pallati i Ri, Shkalla B, Kati i 2, Tiranë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” “Rehabilitimi Unaza e Mesme”.

Numri i referencës së procedurës/lotit REF-46103-02-09-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Rehabilitimi Unaza e Mesme”.

Fondi limit: 249,938,884 (dyqind e dyzet e nëntë milion e nëntëqind e tridhjetë e tetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 360 (treqind e gjashtëdhjetë) ditë kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 04.04.2018, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 7 datë 19.02.2018.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik Varaku E shpk **NUIS J61902509S**

Vlera e ofertës = 0 (zero) lekë.

2. Operatori ekonomik “Alba Construction” shpk **NUIS J61812013R**

Vlera e ofertës = 207,442,422.6 (dyqind e shtatë milion e katërqind e dyzet e dy mijë e katërqind e njëzet e dy pike gjashtë) lekë pa TVSH.

3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri shpk & PC Store shpk **J67902718S**
& **L01606034A**

Vlera e ofertës = 212,413,229.18 (dyqind e dymbëdhjetë milion e katërqind e trembëdhjetë mijë e dyqind e njëzet e nëntë pikë tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik “Company Riviera 2008” shpk NUIS K81716011V

Vlera e ofertës = 236,424,786 (dyqind e tridhjetë e gjashtë milion e katërqind e njëzet katërmijë e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik Varaku E shpk

- Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “Varaku E” shpk ka paraqitur në sistemin elektronik vetëm Ekstraktin Historik të Regjistrimit Tregtar. Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të ofertave.
- Mungesa e dokumentacionit ligjor, ekonomik dhe teknik si dhe mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53, pika 3 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar) si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu VII, Neni 66, pika 3, KVO e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri shpk & PC Store shpk

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se në ofertën e paraqitur nga ky Bashkim Operatorësh ekonomik nuk janë ndarë elementët konkretë sipas zërave të preventivit që do të kryejë secili prej anëtarëve në bazë të përqindjes së bashkëpunimit, çka bie në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu VIII, Neni 74, pika 2 ku përcaktohet se: “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi...”.
- Referuar QKB rezulton se shoqëria “PC Store” shpk nuk ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit, gërma “a”.
- Kontratat e paraqitura nga shoqëria “PC Store” shpk nuk vërtetojnë përvojën e sukseshme pasi janë kontrata furnizimi dhe jo kontrata pune ashtu siç përcaktohet në DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 1.
- Shoqëria “PC Store” shpk nuk ka paraqitur asnjë dokument që të provojë se ka të punësuar pranë shoqërisë 1 (një) mjek të përgjithshëm, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7.
- Shoqëria “PC Store” shpk nuk ka paraqitur asnjë dokument që të provojë se disponon mjetet e kërkuara sipas DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16.

3. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik Company Riviera 2008 shpk.

- Operatori ekonomik “Company Riviera 2008” shpk nuk ka paraqitur asnjë dokument që të provojë se ka të punësuar pranë shoqërisë 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (profili transport), çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 6.
- Referuar dokumentacionit të paraqitur për stafin teknik, rezulton se Operatori ekonomik “Company Riviera 2008” shpk nuk ka të punësuar pranë shoqërisë 1 (një) Inxhinier Mjedisi të pajisur me Çertifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 6.
- Shoqëria “Company Riviera 2008” shpk ka deklaruar se disponon 3 (tre) kamionçina përkatësisht me targa AA 346 LE; AA 426 CZ; si dhe AA 435 JD. Pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetet e deklaruara si më lart, KVO konstatoi se Kamionçina me targë AA 346 LE ka kapacitet mbajtës 5.9 Ton; mjeti me targë AA 426 CZ ka kapacitet mbajtës 1.6 Ton ndërsa meji me targë AA 435 JD ka kapacitet mbajtës 1.3 Ton. Për sa më lart, Operatori ekonomik “Company Riviera 2008” shpk nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) kamionçina me kapacitet mbajtës 3.5 – 5 ton”*.
- Shoqëria “Company Riviera 2008” shpk ka deklaruar se disponon 1 (një) Autobotmatricë me targë TR 4893 L. KVO, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetin e sipërcituar, konstatoi se Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucioni përkatës, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma “b”.
- Referuar Shtojcës 10, Operatori ekonomik “Company Riviera 2008” shpk ka deklaruar se disponon 3 (tre) Autobot Uji. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për secilin mjet, konstatoi se dy prej tyre janë mjet për transport karburanti, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16 ku përcaktohet se: *“Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë 2 (dy) Autobot uji”*.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Company Riviera 2008” shpk, referuar Shtojcës 10 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatori ekonomik “Alba Construction”, me adresë: Rruga “Frederik Shiroka”, Pallati i Ri, Shkalla B, Kati i 2, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 207,442,422.6 (dyqind e shtatë million e katërqind e dyzet e dy mijë e katërqind e njëzet e dy pike gjashtë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 16.04.2018

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), nuk është praqitur asnjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë,

